



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.75, datë 24.04.2023

PËR

**“PLOTËSIMIN E 1 (NJË) POZICIONI PRANË EUROJUST PËRMES
PROCEDURËS SË KOMANDIMIT TË PROKURORËVE”**

Bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 184, germa “d” dhe 189, pika 1, germa “a”, të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenet 53 dhe 54 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 5 të ligjit Nr.113/2018, “Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust-it”, Rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të shpallë fillimin e procedurës për plotësimin e 1 (një) pozicion “Prokuror ndërlidhës pranë Eurojust”, përmes procedurës së komandimit.
2. Afati i komandimit do të jetë 2.5 vjet (dy vjet e gjashtë muaj).
3. Thirrja për plotësimin nëpërmjet procedurës së komandimit për pozicionin “Prokuror ndërlidhës pranë Eurojust”, do të shpallet në faqen zyrtare web të Këshillit, duke përcaktuar kushtet e përgjithshme, kriteret e posaçme, dokumentacionin e nevojshëm dhe afatin e shprehjes së interesit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
5. U shpall në Tiranë, më 24.04.2023.

KRYETAR

Alfred Balla

